

20242754738

Në bazë të nenit 25, paragrafi (1) dhe (3) dhe (47), paragrafi (1), pika 20) nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

**VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE
PREJ 2 DENARË**

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim monedha me vlerë nominale prej 2 denarë me shenjë të shtypjes “2024” dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale prej 2 denarë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 202/16) dhe Vendim për emetim dhe ndryshim të karakteristikave themelore të monedhave me vlerë nominale prej 2 denarë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 149/21), duke filluar nga 1 janari 2025.

2. Monedhat me vlerë nominale prej 2 denarë të lëshuara në pajtim me Vendimin për emetimin, vlerën nominale dhe karakteristikat themelore të monedhave dhe kartëmonedhave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 25/93), Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 2 denarë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 202/16) dhe Vendim për emetim dhe ndryshim të karakteristikave themelore të monedhave me vlerë nominale prej 2 denarë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 149/21), mbeten në qarkullim pagesor të pagesave me para të gatshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V. Nr. 02-43728/5
26 dhjetor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe udhëheqëse e Këshillit të
Bankës Popullore të Republikës
së Maqedonisë së Veriut,
Dr. **Анита Ангеловска-Бежоска**, d.v.